

## GJYKATA E QARKUT PRISHTINË

**K.A. Nr. 339/2010**  
**21 dhjetor 2010**

Gjyqtari për konfirmim, Gjyqtari penal i EULEX-it në Nivelin e Qarkut Klaus Jung, i caktuar me vendimin n. JC/EJU/OPEJ/2098/chs/10, i lëshuar nga zëvendës-kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it Charles L. Smith III më 5 nëntor 2010, në çështjen penale kundër:

- 1) **Fahredin (Faruk) Gashi**, emri i babait Hajredin, i lindur më 8 dhjetor 1969, në Shtime, me banim në Shtime, i martuar, shqiptar nga Kosova, aktualisht në paraburgim në qendrën e Paraburgimit në Prishtinë;
- 2) **Hysri (Hys) Rama**, emri i babait Asllan, i lindur më 5 qershor 1973, në Sankovc (Drenas), i martuar, shqiptar nga Kosova, duke u mbrojtur në liri;

kundër të cilëve është ngritur një aktakuzë me numrat PPS 460/09 dhe PPS 09/2010, më datën 5 nëntor 2010 nga Prokurori Special, Maurizio Salustro dhe ndryshuar gojarisht gjatë seancës së konfirmimit të mbajtur më 25 nëntor 2010, me anë të së cilës akuzohen të pandehurit si në vijim:

**Fahredin Gashi me veprën penale “Krime lufte kundër popullatës civile”,** në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), e që ndëshkohen sipas neneve 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), për shkak të shkëljes së nenit 3 i përbashkët në katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 të Protokollit II të datës 8 qershor 1977, Shtesë e Konventave të Gjenevës 1949, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe në kohën e kryerjes së veprës penale, që në bashkëkryerje me Nazim Bllacën, në cilësinë e tij si anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës(UÇK), ka hyrë në shtëpinë e Sali Gashit dhe e ka vrarë atë me një breshëri të armës automatike, në Varigovc (Lipjan) më 15 qershor 1999;

**Hysri Rama, me veprën penale “Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale”,** parashikuar dhe dënuar sipas nenit 305 paragrafit 2 të Kodit Penal të Kosovës, për arsye se i pandehuri ka ndihmuar Fahredin Gashin (nën hetime për veprën penale Krime lufte kundër popullatës civile për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje me Nazim Bllacën ai ka vrarë Sali Gashin në Varigovc më 15 qershor 1999) për t’iu shmangur zbulimit (a) duke i siguruar babait të Fahredin Gashit një deklaratë të nënshkruar në të cilën i pandehuri ka deklaruar rrejshëm se Nazim Bllaca në vitin 2009 i ka thënë atij se Fahredin Gashi nuk ka të bëjë fare me vrasjen e Sali Gashit dhe se Bllaca do ta akuzonte Gashin vetëm për të zhvatur para nga ai, dhe (b) duke konfirmuar përmbajtjen e një deklaratë të tillë të shkruar me dorë para Prokurorit kur është dëgjuar si dëshmitar më 29 tetor 2010; - Në Prishtinë, më 29 tetor 2010;

Duke vendosur mbi konfirmimin e aktakuzës kundër të dyshuarve të lartpërmendur, pas dëgjimit të palëve më 25 nëntor 2010, duke vënë në dukje se zbulimi i materialeve mbrojtjes është bashkuar në gjykatë më 25 nëntor, vendimi me anë të të cilit Nazim Bllaca shpallet si dëshmitar bashkëpunues dhe të disa faqeve që mungonin në njëri prej deklaratave të dhëna nga Nazim Bllaca, i janë dorëzuar avokatëve mbrojtës, duke marrë parasysh komentet e paraqitura nga avokati Kolë Krasniqi më 1 dhjetor 2010, në pajtim me nenin 316 para. 4) nxjerr si në vijim:

### AKTVENDIM

1. Aktakuza me numrat PPS 460/09 dhe 09/2010 e datës 5 nëntor 2010 përmban informatat e kërkuara me ligj dhe prandaj përmbush kërkesat e nenit 305, paragrafit 1, nën paragrafëve 1 deri 7 të KPPK-së.
2. Prokurori Publik ka përmbushur obligimin në lidhje me zbulimin e provave, siç parashihet me nenet 307 dhe 308 të KPPK-së.
3. Të gjitha provat të cilat përmenden në aktakuzë janë të pranueshme. Të gjitha provat të cilat gjenden në dosjen e Gjykatës apo të cilat janë përmendur në dokumentet të cilat janë paraqitur në Gjykatë janë të pranueshme.
4. **AKTAKUZA KONFIRMOHET** për Pikat e saja në vijim dhe në lidhje me të pandehurit në vijim:
  - Pika I, sa i përket të pandehurit Fahredin Gashi;
  - Pika II, sa i përket të pandehurit Hysri Rama;
5. Pasi që aktakuza të merr formën e prerë, aktakuza dhe shkresat e lëndës duhet t'i dërgohen menjëherë kryetarit të trupit gjykues për shqyrtim gjyqësor.

### ARSYETIM

#### 1) Kompetenca e Gjykatës

Më 9 nëntor 2010 Prokurori Special Maurizio Salustro ka ngritur aktakuzën me numrat PPS 460/09 dhe 09/2010, që është rezultat i dy hetimeve të ndryshme kundër të pandehurve të lartpërmendur.

Kundër Fahredin Gashit pretendohet vepra penale Krime lufte kundër popullatës civile – në lidhje me vrasjen e Sali Gashit- në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), e që ndëshkohen sipas neneve 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), për shkak të shkëljes së nenit 3 i përbashkët në katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 të Protokollit II të datës 8 korrik 1977, Shtesë e Konventave të Gjenevës 1949, që dënohet

me burgim prej jo më pak se 5 vjet deri në maksimum prej 20 vjetëve – maksimumi zëvendëson dënimin me vdekje fillimisht paraparë me nenin 142 të KPRSFJ-së, por që nuk zbatohet dhe prandaj është zëvendësuar, në pajtim me nenin 38 paragrafin 2) të KP-RSFJ-së, deri në maksimum prej 20 viteve burgim.

Kundër të pandehurit të dytë pretendohet vepra penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale- në hipotezën e ndëshkuar sipas nenit 305 para. 2 KPK- për shkak se pretendohet t'i ketë ofruar ndihmë Fahredin Gashit në lidhje me krimin e pretenduar në pikën I të së njëjtës aktakuzë, që dënohet me burgim prej 6 muajve deri në pesë vjet.

Ne pajtim me nenin 23 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tutje: KPPK), kompetencë e Gjykatave të Qarkut është të gjykojnë në shkallë të parë veprat penale të dënueshme me të paktën pesë vjet burgim ose burgim afatgjatë; gjithashtu, në pajtim me nenin 33 paragrafin 4 të KPPK-së *Në parim, gjykata e cila është kompetente për kryerësin e veprës penale është kompetente edhe për bashkëkryerësit dhe ndihmësit pas kryerjes së veprës penale dhe për personat të cilët nuk kanë njoftuar për përgatitjen e veprës, kryerjen e saj ose kryerësin;* prandaj Gjykata e Qarkut është kompetente të merret me të dyja pikat.

Gjykata e Qarkut të Prishtinës është territorialisht kompetente, pasi që vendi ku pretendohet të kenë ndodhur ngjarjet bie nën kompetencën territoriale të kësaj gjykate

Vepra penale bie nën nenin 3, paragrafin 1 të Ligjit mbi kompetencat (3 – L053/2008), që përcakton kompetencat kryesore të Gjyqtarëve të EULEX-it. Neni 3 paragrafi 1 që thotë se Gjyqtarët e EULEX-it kanë juridiksion për çdo lëndë të hetuar a të ndjekur penalisht nga PSRK-ja.

## 2) Të gjeturat e seancës për konfirmim dhe mbi pranueshmërinë e provave

Seanca për konfirmim është mbajtur më 25 nëntor 2010 në praninë e të pandehurit Fahredin Gashi dhe të dy avokatëve të tij, avokatit Kolë Krasniqi dhe avokatit Tahir Rrecaj, i pandehuri Hysri Rama nuk ka qenë asistuar nga avokati mbrojtës, dhe në praninë e prokurorit të PSRK-së Maurizio Salustro. Seanca është mbajtur publikisht dhe në prani të publikut.

I pandehuri Hysri Rama, në bazë të paralajmërimit të qartë të gjyqtarit për konfirmim rreth të drejtës së tij për tu asistuar nga një avokat mbrojtës dhe duke iu përgjigjur pyetjes së drejtpërdrejtë nëse ai dëshironte të asistohet nga një mbrojtës, u përgjigj se ai kishte për qëllim të ushtronte të drejtën për t'u mbrojtur vet; gjyqtari për konfirmim, konsideron se i pandehuri akuzohet me një vepër penale që nuk kërkon mbrojtje të detyrueshme, duke theksuar se gjykatës nuk i është dorëzuar asnjë arsye e veçantë ku sugjerohet caktimi i një avokati mbrojtës ex officio për të pandehurin; duke vënë në pah se i pandehuri ka shprehur lirisht dëshirën e tij që të mos asistohet nga një avokat mbrojtës për qëllimin e kësaj faze të procedurës; seanca shpallet e hapur.

Gjyqtari për konfirmim u ka sqaruar qartazi të pandehurve pretendimet kundër tyre dhe i ka paralajmëruar ata për të drejtat e tyre, në veçanti duke i kujtuar z. Rama për të drejtën e tij që të asistohet nga një avokat. Aktakuza i është lexuar të pandehurve, ata janë informuar për të drejtën e tyre për të pranuar fajin apo të deklarohen të pafajshëm për secilën nga pikat e aktakuzës. Të pandehurit janë deklaruar se i kuptojnë pretendimet e aktakuzës dhe të dytë u deklaruan të pafajshëm ndaj akuzave.

Prokurori Publik ka përmbushur obligimin e tij në lidhje me zbulimin e provave, siç parashihet me nenet 307 dhe 308 të KPPK-së. Veçanërisht, të gjitha deklaratat e dëshmitarëve, palëve të dëmtuara dhe të provave të dokumentuara i janë ofruar mbrojtjes dhe të pandehurve. Avokatët mbrojtës të z. Gashi kanë kërkuar dokumente shtesë, të cilët kanë theksuar vetëm në ditën e seancës se nuk u ishte zbuluar ende vendimi në të cilin z. Bllaca ishte deklaruar dëshmitar bashkëpunues, tutje duke paraqitur se mungonin nga kopja e zbuluar nga prokurori faqet dy, tre, katër, gjashtë dhe shtatë të deklaratës së dhënë nga z. Bllaca më 30 nëntor 2009. Prokurori i ka siguruar avokatëve mbrojtës dokumentacionin e kërkuar dhe gjyqtari i poshtëshënuar u ka dhënë avokatëve mbrojtës 7 ditë që të komentojnë mbi dokumentet e pranuar së fundmi, kështu që Gjykata vie në përfundim se deri më tani janë përmbushur kërkesat e neneve 307 dhe 308 të KPPK-së.

Sa i përket pranueshmërisë së provave, avokatët mbrojtës të z. Gashi kanë paraqitur një propozim me shkrim më datën 30 nëntor 2010 në të cilin paraqesin:

Se zbulimi i urdhërit në të cilin deklarohet z. Bllaca dëshmitar bashkëpunues ishte i vonuar dhe kështu shkel principin e pozitës së barabartë të palëve –sipas nenit 10, paragrafit 1, KPPK, neni 6.3 KEDNJ dhe nenit 14.3.a të Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike.

Se deklaratat e dhëna nga z. Bllaca më 30 nëntor 2009, 3 dhjetor 2009, 21 prill 2010, 28 prill 2010, 29 prill 2010, 30 prill 2010, 4 maj 2010, dhe 6 maj 2010, nuk janë të pranueshme pasi që këto deklarata janë marrë kur z. Bllaca kishte statusin formal të të pandehurit dhe në pajtim me rregullat dhe paralajmërimet e kërkuara për një të pandehur; megjithatë z. Bllaca është shpallur më pas dëshmitar bashkëpunues dhe prandaj ai tani ka statusin e dëshmitarin në këtë procedurë, prandaj deklaratimet e tija të mëparshme mund të pranohen vetëm nëse janë në pajtim me rregullat dhe paralajmërimet e parapara për një dëshmitar kështu që deklarimi i tij i mëparshëm i dhënë si i pandehur duhet të deklarohet si i papranueshëm.

#### Të gjeturat e gjykatës:

Paraprakisht, Gjykata gjen se zbulimi i urdhërit në të cilin deklarohet z. Bllaca dëshmitar bashkëpunues është i bërë me kohë. Në fakt, neni 302 i KPPK-së kërkon se *të pandehurit kundër të cilit duhet të dëshmojë dëshmitari bashkëpunues i jepet një kopje e urdhërit me të cilin personi i tillë është shpallur dëshmitar bashkëpunues para shqyrtimit gjyqësor*. Urdhëri i është dorëzuar avokatëve mbrojtës më 25 nëntor 2010, 7 ditë u janë dhënë atyre për të komentuar mbi ndonjë çështje ligjore që del nga një urdhër i tillë, prandaj ky gjyqtar vie në përfundim se nuk është bërë asnjë shkelje e të drejtave të të pandehurit dhe nuk është gjetur asnjë shkelje e KPPK-së.

Sa i përket pranueshmërisë në këtë fazë të procedurës të deklaratave të dhëna nga z. Bllaca si i pandehur pamvarësisht se statusi i tij ka ndryshuar në dëshmitar bashkëpunues, gjyqtari vëren se rregulla e përgjithshme sipas KPPK-së është se Gjykata ka autoritetin të vlerësojë lirisht të gjitha provat e parashtruara me qëllim të përcaktimit të rëndësisë ose papranueshmërisë së tyre (152 par. 2 KPPK) dhe se provat në përgjithësi janë të pranueshme përveç nëse merren me shkelje të dispozitave të KPPK-së dhe kur papranueshmëria parashikohet shprehimisht (neni 153 KPPK).

Kodi qartazi identifikon dy çështjet e rëndësishme sa i përket provave, pranueshërinë formale, që kronologjikisht është e para, dhe vlerësimi i vlerës së provave, që i referohet rëndësisë konkrete që gjyqtari i jep një prove të vetme në mënyrë kontekstuale.

Duke pasur parasysh se deklaratat e Nazim Bllacës, secila prej tyre, janë marrë në pajtim me ligjin në fuqi për sa i përket statusit formal që Nazim Bllaca ka patur në momentin kur ato janë marrë; duke theksuar se nuk ekziston asnjë ndalim i qartë në KPPK sa i përket papranueshmërisë së deklaratave të bëra nga një bashkë-i pandehur, i cili përfundimisht dëshmon si dëshmitar në procedurë – kur i lejohet me ligj-; duke vënë në pah se është jurisprudencë e konsoliduar e kësaj gjykate t'i lejojë dëshmitarëve të ballafaqohen me deklaratat e dhëna në cilësinë e të pandehurve; duke gjetur hutimin e mbrojtjes sa i përket saktësisë së deklaratave për shkak të paralajmërimeve të ndryshme sa i përket momentit të vlerësimit dhe ato nuk ndikojnë në pranueshmërinë e tyre;<sup>1</sup> dhe përfundimisht, duke pasur parasysh natyrën karakteristike të dëshmitarit bashkëpunues deklarimi i fakteve të të cilit, siç është paraqitur para gjyqtarit të procedurës paraprake, duhet të jetë i saktë dhe në përputhje me dëshminë e tij në të ardhmen, gjyqtari për konfirmim vie në përfundim se deklaratat e kundërshtuara nga avokatët mbrojtës janë të pranueshme.

Duke pasur parasysh se pranueshmëria e të gjitha provave tjera nuk është kundërshtuar nga palët, dhe as nuk ekziston ndonjë arsye për t'i deklaruar ndonjërin prej tyre të papranueshme *ex officio*, sipas vlerësimeve të mësipërme dhe sa i përket dispozitës së nenit 154 paragrafit 6 të KPPK-së, Gjykata vie në përfundim se të gjitha provat që gjenden në dosje të rastit janë të pranueshme.

Gjykata vie në përfundim se aktakuza përmbush të gjitha kërkesat e nenit 305, paragrafit 1 të KPPK-së.

Gjykata vie në përfundim se nuk ekzistojnë bazat për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale sipas nenit 316, paragrafit 1, nën paragrafëve 1 deri në 3 të KPPK-së.

### 3) Dyshimi i bazuar sipas nenit 316, paragrafit 1, nën paragrafit 4 të KPPK-së

<sup>1</sup> Vlerësimi i saktësisë së deklaratës është një moment i ndryshëm dhe nuk i referohet pranueshmërisë së dëshmive, besueshmërisë së deklaratave dhe vlerësimit të vlerës provuese të deklaratave, që duhet të marrë parasysh përputhshmërinë e përshkrimit faktik të dhënë para trupit gjykues dhe kufijve ligjor të paraparë me nenin 157 par. 4 KPPK- Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues. (nenet 298 deri te 303 të këtij Kodi)

Të pandehurit dhe avokatët mbrojtës të z. Gashi të gjithë janë deklaruar për hudhjen poshtë të aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale në pajtim me nenin 316, paragrafin 1, nën paragrafin 4 të KPPK-së, duke paraqitur se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se të pandehurit kanë kryer ndonjëherë nga veprat penale në aktakuzë.

### Sa i përket pikës I

Lidhur me këtë akuzë janë provat në vijim:

- Deklaratat e dëshmitarëve/palëve të dëmtuara: [REDACTED] dosja e plotë hetuese PPS 97/2010, rezultati i përgjimit të telefonatave dhe porosive tekstuale dhe raportet relevante të policisë, deklaratat e të akuzuarve Fahredin Gashi dhe Hysri Rama, dokumentet e konfiskuara gjatë kontrollit të shtëpisë së Fahredin Gashit.

### 3.1 Kualifikimi ligjor

Avokatët mbrojtës të të pandehurit Gashi kundërshtojnë kualifikimin ligjor Krime lufte kundër popullatës civile për veprën penale të pretenduar në aktakuzë, duke paraqitur se një vepër penale mund të kualifikohet si Krim lufte vetëm nëse është kryer gjatë një konflikti të armatosur, prandaj, duke pasur parasysh se vrasja e Sali Gashit është bërë më 15 qershor, përdërisa lufta në Kosovë ka përfunduar më 10 qershor 1999, kjo vrasje nuk mund të kualifikohet si Krim lufte. Data e fundit e armiqësisë është theksuar nga mbrojtja në bazë të *Rregullores së UNMIK-ut 1999/1, që është në fuqi që nga 10 qershori 1999, kur është aprovuar Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244/1999 për Kosovën. Sipas nenit 1 të rregullores në fjalë, UNMIK-u ka rolin e përgjithshëm të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ në Kosovë, dhe këtë pushtet e ushtron përmes PSSP të KB. Nga kjo del se koha kur është kryer vrasja nuk ka qenë kohë lufte, administrata e UNMIK-ut ishte instaluar në Kosovë, KFOR-i ishte në Kosovë si organizatë ushtarake për sigurinë e brendshme dhe të jashtme të Kosovës.*<sup>2</sup>

Gjyqtari e konsideron si të saktë paraqitjen e mbrojtjes në pjesën kur cek se vepra e nënvizuar për t'u karakterizuar si Krime lufte kundër popullatës civile - në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tutje KPRSFJ), e që ndëshkohet sipas nenit 120 të Kodit Penal të Kosovës (tutje KPK), elementet shtesë – vepra do të kryhej brenda një konflikti të armatosur dhe në lidhje me konfliktin e armatosur, prandaj në një rast të tillë, së bashku me elementet e nevojshme për të vërtetuar vrasjen e Sali Gashit, prokurori duhet gjithashtu të vërtetojë elementet themelore:

- a. Ekzistimi i një konflikti të armatosur në Kosovë në kohën përkatëse;
- b. Ekzistimi i një lidhjeje në mes të konfliktit të armatosur dhe krimit të pretenduar;

<sup>2</sup> Fragment nga parashtrësja e mbrojtjes e datës 30 nëntor 2010, faqe 6

- c. Statusi i viktimës si person i mbrojtur sipas konventave të Gjenevës;
- d. Se pretendimet faktike të pikave të mbetura shkelin që të dyja: ligjin vendor dhe rregullat e zbatueshme të ligjit ndërkombëtar në fuqi – test i dyfishtë -. koha e luftës, konflikti i armatosur apo profesioni.

### 3.1.a) Ekzistimi i një konflikti të armatosur

Definicioni i një konflikti të armatosur nuk është dhënë në Konventën e Gjenevës. Jurisprudenca e Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavi, do të thotë para. 70 i Vendimit të Jurisdiksionit të Tadiqit vie në përfundim se *një konflikt i armatosur ekziston sa herë që ka një përdorim të forcës së armatosur në mes Shteteve apo një dhunë të zgjatur të armatosur në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura apo midis grupeve të tilla brenda një shteti. E drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet nga fillimi i konflikteve të tilla të armatosura dhe vazhdon pas pushimit të armiqësive deri sa të arrihet një marrëveshje e përgjithshme për paqe; ose, në rastin e konflikteve të brendshme, të jetë arritur një zgjidhje paqësore. Deri në atë moment, e drejta ndërkombëtare humanitare vazhdon të zbatohet në tërë territorin e Shteteve ndërluftuese apo, në rast të konflikteve të brendshme, i tërë territori nën kontrollin e një pale, nëse ndodh apo jo një luftë aktuale.*

Ekzistimi i një konflikti të armatosur është një vlerësim faktik. Të dyja palët pranojnë se në Kosovë ka ekzistuar një konflikt i armatosur në vitin 1999, megjithëse, pretendimi i ngritur nga prokuroria se ka ekzistuar një konflikt i armatosur i karakterit jo ndërkombëtar në kohën kur është kryer vrasja e Sali Gashit, duke kundërshtuar avokatët mbrojtës të z. Gashi që theksojnë se armiqësia ka përfunduar më 10 qershor 1999. Në vlerësimin e tij, gjyqtari nuk gjen se nxjerrja e rezolutës së UNMIK-ut, *per se*, të përjashtojë ekzistimin e një konflikti në kohën përkatëse të aktakuzës.

Në fakt, dihet mirë se në Kosovë në vitin 1999 në të njëjtën kohë kanë bashkë-ekzistuar një konflikt i armatosur ndërkombëtar dhe një jo ndërkombëtar. Konflikti ndërkombëtar ka përfunduar më 9 qershor 1999, me nënshkrimin e Marrëveshjes Teknike Ushtarake në mes forcave të NATO-s dhe Qeverive të ish Republikës së Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë (MTU), ku me largimin e forcave të ish Republikës së Jugosllavisë, dhe tërheqjen e njëjës prej dy palëve në konflikt, *de facto* ka përfunduar konflikti ndërkombëtar.

Sidoqoftë, përfundimi i konfliktit ndërkombëtar nuk ka zgjidhur *per se* konfliktin e brendshëm në vazhdim në mes të UÇK-së, që ka patur *de facto* kontroll të përgjithshëm mbi një pjesë të identifikuar të Kosovës, dhe të forcave të ish Republikës së Jugosllavisë. Në fakt, vetëm më 20 qershor 1999, është nënshkruar nga UÇK, Marrëveshja për demilitarizim dhe transformim dhe nga vetë fjalët e përdorura në marrëveshje në para. 6,

dhe 8 deri në 14, se kur është nënshkruar marrëveshja, armiqësitë në territorin e Kosovës nuk kishin përfunduar ende dhe luftimi ishte ende duke u zhvilluar.

Ky gjyqtar prandaj vie në përfundim se ka ekzistuar konflikti i armatosur i karakterit jo ndërkombëtar në kohën relevante të aktakuzës – pra. 6 ditë pas nënshkrimit të MTU dhe 4 ditë para nënshkrimit marrëveshjes – pasi që elementet faktike tregojnë se kishte ende armiqësi në Kosovë në atë kohë. Qartazi qëllim i Konventës së Gjenevës është të garantojë të drejtat e personave të mbrojtur kur konkretisht është e nevojshme. Neni 3 i përbashkët, dhe karakteristikat e tij përmes protokollit shtesë II, ka për qëllim të garantojë personat të cilët nuk marrin pjesë në armiqësi kur armiqësitë janë *in concreto* në vazhdim, prandaj, përkundër statusit formal, zbatimi i tij duhet të jetë në përputhje me qëllimin e tij në çdo kohë kur nuk është zgjidhur një konflikt i karakterit ndërkombëtar dhe deri sa të zgjidhet përfundimisht.

### 3.1.b) Ekzistimi i lidhjes në mes të konfliktit të armatosur dhe krimit të pretenduar

Ekzistimi i një lidhjeje përfshin një lidhje të ngushtë në mes të veprës së nënvizuar dhe armiqësive në vazhdim.<sup>3</sup> Në këtë rast të posaçëm lidhja është provuar nga dëshmitari bashkëpunues në deklaratën e tij. Në fakt, Nazim Bllaca ka deklaruar se të dytë, ai dhe Fahredin Gashi kanë qenë anëtarë të UÇK-së – rrethanë që nuk është kundërshtuar nga Fahredin Gashi-, dhe se Fahredin Gashi i ka thënë atij pas vrasjes, se Sali Gashi është dashur të vritej për shkak të bashkëpunimit të tij me forcat serbe – forcë kundërshtare ndaj UÇK-së në kohën e konfliktit – me anë të kësaj duke treguar një lidhje të drejtpërdrejtë në mes të vrasjes dhe konfliktit.

### 3.1.c) Statusi i viktimës si person i mbrojtur në bazë të konventave të Gjenevës

Neni 3 i përbashkët për Konventat e Gjenevës, dhe protokollit të tij shtesë II, të dyja mbrojnë popullatën civile gjatë kohës së një konflikti të karakterit jo ndërkombëtar (tutje konflikte të brendshme). Statusi i personit civil të z. Sali Gashi në kohën e krimit nuk është diskutuar nga asnjëra palë. Sali Gashi nuk kishte të veshur një uniformë, nuk ishte i armatosur, dhe ishte në shtëpinë e tij, i shtrirë në divan kur ai u qëllua dhe u vra nga kryerësit e veprës. Është e qartë nga provat në dosje se, kur është vrarë, Sali Gashi nuk ka marrë pjesë në konflikt në cilësi aktive apo të ketë qenë përfshirë në ndonjë aktivitet ushtarak, prandaj ai bie në kategorinë e personave të mbrojtur sipas nenit 3 të përbashkët në Konventat e Gjenevës.

<sup>3</sup> Jurisprudenca ndërkombëtare thekson, në mes të elementeve tjera të vlefshme për të konkluduar një vlerësim të tillë, se një lidhje e mjaftueshme ekziston nëse tregohet, *inter alia*, se: (1) kryerësi i veprës ka qenë një luftëtar; (2) viktima nuk ka qenë luftëtar; (3) viktima është anëtar i palës kundërshtare; (4) vepra mund të thuhet t'i shërbejë qëllimit përfundimtar të fushatës ushtarake; apo (5) krimi është kryer si pjesë apo në kontekst të detyrave zyrtare të kryerësit të veprës, shih Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavi, Prokurori Vs. *Kunarac Aktgjykimi i Ankimuar*, para. 59.

3.1.d) Se pretendimet faktike shkelin ligjin vendor dhe rregullat e zbatueshme të ligjit ndërkombëtar, që ishin në fuqi në kohën e luftës

Në rastin e posaçëm, vrasja e personave civil, dënohet qartazi nga ligji vendor, sipas nenit 142 KP-RSFJ-së, dhe nenit 120 të KPK-së. Vrasja e paligjshme e civilëve është gjithashtu një vepër penale bazuar në Konventat e Gjenevës, sipas nenit 3 të përbashkët dhe nenit 4 të Protokollit të tij Shtesë II, të dy të zbatueshëm në rastin specifik. Sa i përket zbatueshmërisë së Konventave të Gjenevës në Kosovë në kohën përkatëse, ia vlen të përmendet se katër Konventat e Gjenevës ishin ratifikuar nga Republika Popullore e Jugosllavisë më 21 prill 1950; përderisa protokollat shtesë I dhe II ishin miratuar më 8 qershor 1977, dhe kanë hy në fuqi më 7 dhjetor 1978, prandaj të gjithë kanë hyrë në fuqi në Kosovë që nga data 22 mars 1989, që përfshin periudhën e konfliktit të armatosur dhe të dytë në rastin specifik, pasi që ishin të zbatueshëm në rast të *konfliktit të armatosur të një karakteri jo ndërkombëtar që do të paraqitej në territorin e njëres nga Palët e Larta Kontraktuese*,<sup>4</sup> dhe Protokollit Shtesë II, që zhvillon dhe plotëson nenin 3.<sup>5</sup>

Standardi i provave në fazën e konfirmimit është “dyshimi i bazuar” siç është caktuar në nenin 316 paragrafin 1 nën paragrafin 4 të KPPK-së. Sipas interpretimit të tij, të bërë nga Gjykata në rastin e *Mehmet Morinës*: “... *standardi duhet të jetë një provë e tillë që – nëse pranohet – mund të çojë tek një konkluzion që është më shumë e mundur se jo që një vepër specifike të jetë kryer. Në këtë drejtim, provat e paraqitura nga prokuroria duhet të jenë në gjendje të sugjerojnë se janë kryer të gjitha elementet e veprës penale*”.<sup>6</sup>

Pas shqyrtimit të provave të bashkëngjitura aktakuzës sipas interpretimit të përmendur, Gjykata vëren si në vijim:

Nazim Bllaca<sup>7</sup> deklaroi se më 15 qershor 1999, ai ka takuar Fahredin Gashin në fshatin Pjetreshicë, nga ku, të njëjtën natë, ata kanë shkuar në këmbë për në fshatin Varigovc duke kërkuar për shtëpinë e Sali Gashit. Kur ata kanë arritur në lagjen e Sali Gashit, në mes të orës 21:00 dhe 22:00, duke mos qenë në gjendje të identifikojnë shtëpinë e Saliut, kanë arritur tek njëra prej shtëpive që rastësisht kanë gjetur vëllain e Saliut (të ndjerin Shefki Gashin) të cilin e kanë detyruar që t'i shoqërojë ata për tek shtëpia e Saliut.

Kur kanë arritur te shtëpia e Saliut, Shefki Gashi ka thirrur personin nga ana tjetër që të hapë derën; Shefkije Gashi ka hapur derën dhe menjëherë ka marrë një të goditur nga njëri prej burrave. Të dy burrat, vazhdimisht të përshkruar që mbanin maska të zeza dhe dorëza dhe vringëllonin armët automatike,<sup>8</sup> kur kanë hyrë në dhomën ku Sali Gashi ishte

<sup>4</sup> Neni i përbashkët 3, Konventat e Gjenevës, presje I

<sup>5</sup> Protokollit shtesë I, Konventat e Gjenevës, neni I

<sup>6</sup> Mbi standardin e dyshimit të bazuar, shih gjithashtu Vendimin e Ankimuar të Gjykatës Supreme në çështjen penale kundër Sedat Hotit.

<sup>7</sup> Procesverbali i seancës së të dyshuarit, i datës 30 nëntor 2009, faqe 7 dhe pason, versioni në anglisht; procesverbali i seancës së të dyshuarit, i datës 3 dhjetor 2009, faqe 10 dhe pason; Letra e përfshirë në procesverbalin e seancës së të dyshuarit, të datës 21 prill 2010, faqe 9 dhe pason

<sup>8</sup> Procesverbal i dëshmitares ██████████, seanca 6 shkurt 2010,

shtrirë në divan pranë gruas së tij dhe, dhe përfundimisht, njëri prej tyre ka shtënë me një breshëri nga arma e tij automatike duke e vrarë Sali Gashin në vend. Pas vrasjes, dy burrat e maskuar kanë dalur nga shtëpia dhe sipas Nazim Bllacës, vetëm pas vrasjes, Fahredin Gashi i ka sqaruar atij se Sali Gashi është dashur të vritej pasi që ai ka qenë bashkëpunëtor i regjimit serb.

Përshkrimi fizik i dy burrave të maskuar është bërë në mënyrë të njëjtë në deklaratat të ndryshme: njëri i gjatë dhe më i dobët përderisa tjetri është dukur më i shkurtër dhe më i plotë; Nazim Bllaca në deklaratën e tij jep identitetin e dy burrave, duke e identifikuar veten me të gjatin dhe Fahredin Gashin me tjetrin. Trupat e Nazim Bllacës dhe Fahredin Gashit përputhen me identifikimin e dhënë nga Bllaca për dy burrat e maskuar dhe në pajtueshmëri me përshkrimin fizik të dy burrave të dhënë nga dëshmitarët.

Përshkrimi i ngjarjeve nga Nazim Bllaca duket të mbështetet nga dëshmitë e palëve të dëmtuara: [REDACTED] pranishëm në shtëpi kur është vrarë Sali Gashi – dhe përmban detaje që kanë mundur të dihen vetëm nga dikush që ka qenë i pranishëm në shtëpinë e Saliut në natën e vrasjes. Palët e dëmtuara konfirmojnë se nuk kanë mundur t'i shohin në fytyrë kryerësit e veprës penale (dy sulmuesit kanë qenë të maskuar gjatë aksionit), por kanë dhënë një përshkrim të përafërt të formës së trupit të tyre (njëri i gjatë, tjetri i shkurt dhe i plotë) dhe kanë dhënë një vlerësim të ngjarjeve që përputhen me atë të dhënë nga Nazim Bllaca në deklaratat e tij të ndryshme.

Gjyqtari gjithashtu gjen se besueshmëria e shpjegimit të Nazim Bllaca mbështetet nga materiale dhe prova tjera të cilat gjenden në dosjen e rastit të cilat, edhe pse nuk i referohen drejtpërdrejtë natës së incidentit, ofrojnë një vërtetim sa i përket stories së Nazim Bllacës dhe tërthorazi mbështesin besueshmërinë e tij.

Është vërejtur se ekzistojnë disa mospërputhje të vogla në mes të deklaratës së z. Bllaca dhe sqarimeve të dhëna nga dëshmitarët, gjithashtu në mes vet dëshmitarëve, megjithëse dëshmitarët duken të përputhen në përshkrimin e ngjarjeve të cilat ata i kanë parë drejtpërdrejtë. Për më tepër dëshmitarët përputhen në përshkrimin e përgjithshëm të ngjarjeve sa i përket të gjitha pikave të rëndësishme, dhe dallimet në detajet e vogla do të konsiderohen si pasojë e kohës së gjatë që ka kaluar në mes të kohës kur kanë ndodhur ngjarjet dhe kohës kur janë dhënë deklaratat, dhe do të theksohet se dëshmitë nuk janë përgatitur apo përndryshe nuk është ndërhyrë në to.

Duket e pabesueshme në këtë fazë të procedurës, pohimi i mbrojtjes se stória e Bllacës është vetëm një e kurdisur për qëllim të përfitimit material dhe zhvatjes. Gjyqtari duke i marrur parasysh elementet në dispozicionin e tij, nuk është i bindur për saktësinë e pohimit të mbrojtjes dhe nuk e konsideron këtë pretendim të pambështetur të pengojë kredibilitetin e z. Bllaca. Në të njëjtën mënyrë, pohimi i avokatit mbrojtës se Fahredin Gashi e ka dorëzuar AK-47-shin e tij më 9 qershor 1999, në këtë fazë nuk është mbështetur me prova, nuk e hedh poshtë pretendimin e aktakuzës. Në fakt, AK-47-shi i përdorur natën e vrasjes nuk është gjetur dhe nuk është pohuar asnjëherë të jetë AK-47-shi që është përdorur nga Fahredin Gashi gjatë luftës. *Contrario*, fakti se z. Gashi ka

patur një AK-47 të dhënë atij gjatë luftës vetëm se ka treguar aftësinë e tij teknike për të vepruar me një armë.

Për shkak të asaj që u tha ma lart, dhe duke marrë parasysh të gjitha elementet në dispozicionin e tij, gjyqtari gjen se ekziston dyshimi i bazuar se Fahredin Gashi, së bashku me Nazim Bllacën, në natën e 15 qershorit 2010, si anëtarë të UÇK-së gjatë një konflikti të brendshëm të armatosur me një lidhje me konfliktin, kanë hyrë në shtëpinë e Sali Gashit dhe e kanë vrarë atë me një breshëri të armës automatike, në Varigovc (Lipjan).

Prandaj, gjyqtari ka vendosur si në dispozitiv sa i përket pikës I.

### Sa i përket pikës II

**Lidhur me këtë akuzë janë provat në vijim:**

Deklaratat e dëshmitarëve/palëve të dëmtuara dhe të pandehurit: Deklarata e shkruar me dorë e nënshkruar nga i pandehuri Hysri Rama, deklarata e dhënë nga Hysri Rama Policisë së EULEX-it më 27 janar 2010, deklarata e dhënë nga Hysri Rama si i pandehur më 29 tetor 2010, pasta nga [REDAKTUAR]

[REDAKTUAR] a e plotë hetuese PPS 977/2010, rezultati i përgjimit të telefonatave dhe porosive tekstuale dhe raportet relevante të policisë.

### 3.2 Kualifikimi ligjor

Kualifikimi ligjor i pretendimeve faktike kundër z. Rama nuk është kundërshtuar nga i pandehuri.

Neni 305 paragrafi 2)

*Kushdo që ndihmon kryerësin e veprës penale për të cilën është paraparë dënim me burgim mbi pesë vjet dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.*

Të kuptuarit se çfarë do të thotë me “ndihmë” për qëllim të këtij neni, mund t’i bëhet referencë listës së pafund nën paragrafin 1 të të njëjtit nen, që tregon se “ndihmon” kryerjen e veprës penale kushdo e ndihmon atë në shmangien e zbulimit të veprës përmes fshehjes së mjeteve, provave a në çfarëdo mënyre tjetër, ose kushdo që strehon personin e dënuar apo ndërmerr veprime për pengimin e ekzekutimit të dënimit a urdhrin për trajtim të detyrueshëm.

Elementet e veprës penale prandaj munden të pranohen si në vijim:

1. një vepër penale është kryer nga një person përveç të pandehurit;
2. i pandehuri ka njohuri për veprën penale të nënvizuar;
3. i pandehuri me veprimet e tij, apo lëshimeve ndihmon kryerësin e veprës penale të nënvizuar;

3.2.1 Në rastin specifik, vepra penale në fjalë është vrasja e Sali Gashit, që është gjithashtu pjesë e këtyre procedurave penale;

3.2.2) Njohuria e veprës penale në fjalë – vrasja e Sali Gashit- është provuar qartazi nga pretendimi faktik dhe është tanimë i qartë në deklaratat e të pandehurit, duke pasur parasysh se në këtë rast specifik, ndihma pretendohet të jetë dhënë përmes dëshmisë së rrejshme.

3.2.3) Pretendimi është se i pandehuri me njohurinë e pretendimeve faktike kundër z. Fahredin Gashi, dhe në kundërshtim me deklaratën e tij të mëparshme dhënë Policisë së EULEX-it më 27 janar 2010, e ka ndryshuar versionin e tij të fakteve për të diskredituar deklaratën e Nazim Bllacës dhe për t'i ofruar ndihmë Fahredin Gashi për t'iu shmangur zbulimit.

Provat tregojnë se më 27 janar 2010 i pandehuri, kur është intervistuar nga Policia e EULEX-it, ka deklaruar se dikur në vitin 2009 ai ka vozitur Bllacën me veturën e tij për në fshatin Varigovc për të takuar familjen e të ndjerit Sali Gashi, dhe se *Bllaca nuk më ka thënë se pse ai dëshironte të fliste me atë familje, dhe unë nuk kam mundur të dëgjoj bisedën.*<sup>9</sup>

Kjo deklaratë është në kundërshtim në pjesën kryesore nga i njëjti i pandehur në një dokument të shkruar me dorë të një date të pasigurt, autorësinë e së cilit i pandehuri e konfirmon në deklaratën e tij dhënë Prokurorit Publik më 29 tetor 2010. Në këtë letër të shkruar me dorë, Hysri Rama konfirmon shoqërimin e Nazim Bllacës për në fshatin Varigovc në vitin 2009, por gjithashtu thotë se ai po shkonte të fliste me djemtë e Sali Gashit për t'i thënë atyre se ai vet (Nazim Bllaca) dhe Fahredin Gashi, e kishin vrarë Sali Gashin në qershor të vitit 1999. Hysri Rama tutje deklaron se Bllaca i ka thënë atij se Fahredin Gashi nuk ka të bëjë fare me vrasjen e Sali Gashit, që në fakt është kryer nga Bllaca dhe dikush tjetër, identitetin e të cilit Bllaca nuk do ta zbulojë, kështu që duke e raportuar Fahredin Gashin tek të afërmit e viktimës, Bllaca ka patur për qëllim të zhasë para nga Gashi. Përfundimisht, Rama ka konfirmuar se ai nuk ka mundur të dëgjojë përmbajtjen e bisedës në mes Bllacës dhe të afërmit të Sali Gashit, pasi që ai ka ndenjur brenda në veturë.

Përmbajtja e kësaj letre të shkruar me dorë, dhe autorësia, është vërtetuar nga i pandehuri kur është intervistuar nga Prokurori më 29 tetor 2010. I pandehuri ka theksuar se kjo letër i është dhënë babait të Fahredin Gashit dhe kur është pyetur nga prokurori që të sqarojë mospërputhjen me deklaratën e tij të mëparshme, ai ka konfirmuar se ajo që është shkruar në letër është e vërtetë dhe ndryshimi është për shkak të faktit *sepse në fillim Bllaca nuk ka sqaruar gjithçka në detaje. Ai ka qenë thjesht i paqartë.*<sup>10</sup>

Sqarimin e bërë nga i pandehuri gjyqtari e konsideron të pabesueshëm. Deklarata e Nazim Bllacës është transmetuar në media dhe raportuar gjerësisht nga shtypi. I pandehuri është intervistuar disa herë nga prokurori i PSRK-së dhe është e pabesueshme se ai asnjëherë nuk ka menduar të përmend faktet të cilat ai i ka konsideruar të kenë rëndësi të madhe për hetimin penal – Nazim Bllaca të ketë pranuar vrasjen dhe shpikjen e provave kundër dikujt tjetër me qëllim të zhvatjes së parave -, posaçërisht duke pasur

<sup>9</sup> Deklarata e dëshmitarit të dhënë nga Hysri Rama më 27 janar 2010, faqe 4 versioni në anglisht

<sup>10</sup> Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit, Hysri Rama, 29 tetor 2010, faqe. 3 versioni në anglisht.

parasysh faktin se Fahredin Gashi ishte privuar nga liria dhe pretendimet kundër tij tanimë ishin bërë publike në korrik 2010.

Gjyqtari, duke gjetur të pavërteta deklaratat e fundit të të pandehurit, duke vënë re mospërputhjen në mes të dy "storieve" dhe se deklaratat e reja të të pandehurit kanë qartazi për qëllim që të ndikojnë fuqishëm në procedurën kundër Fahredin Gashit dhe të prishin besueshmërinë e deklaratës së dhënë nga Nazim Bllaca, me qëllim që t'i ndihmojë Fahredin Gashi për t'iu shmangur ndjekjes duke dhënë dëshmi të rrejshme, vie në përfundim se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri Hysri Rama qëllimisht dhe me dëshirë ka dhënë deklarata të rrejshme me qëllim që ta ndihmojë Fahredin Gashin që t'i shmanget ndjekjes për vrasjen e Sali Gashit; prandaj, gjyqtari gjen se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri, ka kryer veprat penale të cilat pretendohen kundër tij në pikën II të aktakuzës, dhe në bazë të elementeve në dispozicion, prandaj, ai ka vendosur si në dispozitiv sa i përket pikës II.

Bazuar në arsyetimin e lartpërmendur, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

---

**Klaus Jung**  
**Gjyqtar për konfirmim i EULEX-it**

Mjetet ligjore:

Në pajtim me nenin 432 dhe nenin 434 (2) të KPPK-së ankesa kundër aktvendimit i paraqitet kolegjit prej tre gjyqtarëve të kësaj gjykate, brenda tri (3) ditëve nga data dhe koha e dorëzimit të tij palëve dhe personave të drejtat e të cilëve janë shkelur.